



RAPORT VJETOR 2022



RAPORT VJETOR 2022

PËRMBAJTJA

7 Hyrje

9 1. BASHKËPUNIMI SHOQËRI CIVILE - QEVERI

9 1.1 Takimet e Këshillit për Bashkëpunim Shoqëri Civile - Qeveri

11 1.2 Projekti 'Zbutja e Ndikimit të Pandemisë COVID-19 tek OSHC-të që ofrojnë Shërbime në Kosovë'

11 Punëtoritë me Këshillin për Bashkëpunim Shoqëri Civile - Qeveri Kontraktimi i Shërbimeve

13 Diskutimi i Ekspertëve mbi praktikat e mira të kontraktimit të shërbimeve për OSHC-të (Praktikat Rajonale dhe të Bashkimi Evropian)

13 Publikimi i raporteve rreth kontraktimit të shërbimeve në Kosovë

13 'Hartëzimi dhe Sfidat e Organizatave të Shoqërisë Civile në Ofrimin e Shërbimeve Sociale dhe Familjare në Kosovë'

14 Publikimi i raportit 'Korniza Ligjore në Republikën e Kosovës Lidhur me Kontraktimin e Shërbimeve nga OJQ-të'

15 Finalizimi i dokumentit "Rekomandimi i Politikave Lidhur me Kontraktimin e Shërbimeve nga ana e OSHC-ve

15 1.3 Aktivitetet në kuadër të Programit për Angazhim Qytetar (CEA)

17 Grupet tematike

19 Takimet rajonale

21 Takimet me përfaqësuesit e shoqërisë civile në Këshillin për Bashkëpunim Shoqëri Civile - Qeveri

22 Takimet me sekretarët e përgjithshëm të ministrive dhe Zyrës së Kryeministrit

22 Monitorimi i Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023

23 2. RRITJA E BASHKËPUNIMIT SHOQËRI CIVILE - QYTETARË

23 2.1 Projekti "Përforcimi i Zërave Lokal Përmes Pjesëmarrjes Aktive"

23 Bashkëpunimi me institucionet qendrore

26 Bashkëpunimi me qeverisjet lokale dhe organizatat lokale

28 Punëtoritë dyditore me përfaqësues të Këshillave Lokale dhe organizatave të shoqërisë civile

30 Lansimi i Platformës KerkoQasje.com

- 31 2.2 Auditimi Social në Kamenicë, Rahovec, Lipjan dhe Pejë
- 31 Projektet e përzgjedhura në kuadër të Auditimit Social në katër komunitat partnere
- 32 Mbështetja e Grupeve të Auditimit Social dhe lehtësimi i takimeve në katër komunitat partnere
- 33 2.3 Vazhdimi i kampanjës për promovimin e vaksinimit #NiseMuhabetin
- 33 Konferenca: '2 vjet me Pandeminë – vazhdim i përpjekjeve për një menaxhim më të mirë'

- 35 3. SHËRBIMET E SEKRETARIATIT TË PLATFORMËS CIVIKOS PËR ORGANIZATAT ANËTARE
- 35 3.1 Të gjeturat e raportit të BE-së për Kosovën 2022
- 36 3.2 Avokimi për politikën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në Kosovë
- 36 3.3 Shërbimi informues për organizatat anëtare gjatë vitit 2022
- 36 3.4 Përzgjedhja e anëtareve të shoqërisë civile në trupa të ndryshëm publik

HYRJE

Puna e Platformës CiviKos gjatë vitit 2022 është e fokusuar në zbatimin e aktiviteteve në funksionin e **ngritjes së bashkëpunimit me organizatat anëtare, promovimin e punës së organizatave anëtare**, si dhe **rrjetëzimin në mes organizatave me veprim lokal me autoritetet publike**.

Përveç komponentës së anëtarësisë, Platforma CiviKos ka punuar në **fuqizimin e rolit të Këshillit për Bashkëpunim në mes të Qeverisë dhe Shoqërisë Civile**. Ky angazhim i Platformës CiviKos ka pasur për qëllim që të përshpejtoj zbatimin e aktiviteteve të Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023.

Gjatë vitit 2022, Platforma CiviKos ka vazhduar me bashkëpunimin me sektorin privat përmes partneritetit të ngushtë me Odën Ekonomike të Kosovës. Ky bashkëpunim ka zgjeruar edhe më tej misionin e Platformës CiviKos me qëllim të diversifikimit të partnerëve, duke sjellur në skenë hisedarë të ri dhe duke shërbyer si urë në mes sektorit publik dhe privat. Auditimi Social ka qenë po ashtu një komponentë e re, ku Platforma CiviKos me mbështetje të DEMOS ka zbatuar komponentën e auditimit social në katër komuna të Kosovës.

Të gjitha aktivitetet e mëposhtme reflektojnë përpjekjet që sekretariati ka bërë për t'i shërbyer organizatave anëtare, por edhe për të krijuar një ambient sa më të favorshëm për funksionimin e shoqërisë civile në Kosovë – kjo e fundit e realizuar në bashkëpunim të ngushtë me organizatat anëtare, dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile pjesë e Këshillit për Bashkëpunim në mes të Qeverisë dhe shoqërisë Civile.

Platforma CiviKos falenderon të gjitha organizatat anëtare për besimin dhe bashkëpunimin, si dhe iu uron mirëseardhje organizatave të reja që janë bashkuar me ne, për të forcuar edhe më tej këtë platformë. Po ashtu një falënderim edhe për autoritetet publike që kanë treguar nivel solid të bashkëpunimit – sidomos Zyrën për Qeverisje të Mirë (ZQM/ZKM). Platforma CiviKos falënderon donatorët që kanë besuar dhe mbështetur punën tonë, duke shpresuar që ky bashkëpunim do të na përcjellë edhe në vitet në vazhdim.

1. BASHKËPUNIMI SHOQËRI CIVILE - QEVERI

1.1 Takimet e Këshillit për Bashkëpunim Shoqëri Civile - Qeveri

Gjatë vitit 2022 janë mbajtur takimet e Këshillit për Bashkëpunim Shoqëri Civile - Qeveri dhe ekipeve të punës që funksionojnë në kuadër të Këshillit. Këshilli ka mbajtur katër takime, në takimin e parë, nga përfaqësuesi i projektit EU TACSO 3 është bërë prezantimi i gjetjeve nga hulumtimi në zyrë dhe intervistat, prezantimi i parakushteve të nevojshme për funksionimin e sistemit të menaxhimit të performancës, prezantimi i sistemit dhe funksionaliteteve dhe përdorimi i tij. Këshilli ka mbajtur një punëtori dyditore për të diskutuar rreth funksionimit të Këshillit dhe ekipeve të punës dhe për të punuar në hartimin e rregullave të punës të ekipeve të Këshillit. Si rezultat, në fund të vitit 2022, nga Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm në Zyrën e Kryeministrit, Arben Krasniqi, si Kryesues dhe znj. Donika Emini, si bashkë-kryesuese e Këshillit për Bashkëpunim të Qeverisë me Shoqërinë Civile, është nënshkruar vendimi i ri për themelimin e ekipeve të punës të Këshillit. Po ashtu, gjatë këtij viti janë mbajtur edhe dy takime të rregullta të Këshillit, në të cilat është diskutuar për progresin e arritur dhe sfidat në zbatimin e Strategjisë, si dhe punën e anëtarëve të Këshillit në këtë proces.



Foto: Punëtorja e Këshillit



Foto: Takimi i rregullt i Këshillit



Foto: Takimi i rregullt i Këshillit

Ekipet e punës të cilat funksionojnë në kuadër të Këshillit për Bashkëpunim Shoqëri Civile – Qeveri e kanë mbajtur nga një takim të rregullt gjatë vitit 2022, ku në këto takime është diskutuar për zbatimin e objektivave të Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile, dhe planet e punës për vitin 2023.

Gjatë vitit 2022 janë organizuar edhe takime të përbashkëta të koordinatorëve, si dhe një takim ndërmjet koordinatorëve të ekipeve të punës të Këshillit dhe sekretarëve të përgjithshëm me qëllim të diskutimit rreth mbarëvajtjes së procesit të zbatimit të Strategjisë dhe parapërgatitjes për takimet e rregullta të Këshillit.



Foto: Takimi i koordinatorëve të ekipeve të punës të Këshillit



Foto: Takimi mes koordinatorëve të ekipeve të punës të Këshillit dhe sekretarëve të përgjithshëm

1.2 Projekti ‘Zbutja e Ndikimit të Pandemisë COVID-19 tek OSHC-të që ofrojnë Shërbime në Kosovë’

Projekti “Zbutja e Ndikimit të Pandemisë COVID-19 tek OSHC-të që ofrojnë Shërbime në Kosovë”, ka zgjatur nga nëntori 2021 deri në nëntor 2022, dhe është financuar nga USAID përmes Balkan Trust for Democracy - Projekti i German Marshall Fund i Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Qëllimi i këtij projekti ishte, matja e ndikimit të pandemisë COVID-19 tek organizatat që ofrojnë shërbime, hartëzimi i organizatave ofruese të shërbimeve në Kosovë, si dhe vendosja e bazës të politikave të kontraktimit të shërbimeve në Kosovë. Në arritje të këtij qëllimi u organizuan aktivitetet e mëposhtme.



Foto: Punëtorja për finalizim të raportit për hartëzim të organizatave ofruese të shërbimeve

Punëtoritë me Këshillin për Bashkëpunim Shoqëri Civile - Qeveri Kontraktimi i Shërbimeve

Platforma Civikos në partneritet me Zyra për Qeverisje të Mirë me datë organizuan punëtorinë e radhës me grupin punues për kontraktim të shërbimeve në kuadër të Këshillit për Bashkëpunim Shoqëri Civile - Qeveri. Kjo punëtori është organizuar në funksion të vendosjes së bazave të rekomandimit të politikave për rregullimin e një sistemi të qëndrueshëm të kontraktimit të shërbimeve në Kosovë.

Punëtorja e radhës në kuadër të projektit “Zbutja e Ndikimit të Pandemisë COVID-19 tek OSHC-të që Ofrojnë Shërbime në Kosovë”, është mbajtur me datë 8 korrik 2022. Kjo punëtori është organizuar në partneritet me Zyrën për Qeverisje të Mirë/ Zyra e Kryeministrit. Anëtarët e Këshillit dhe organizatat ofruese të shërbimeve kanë dhënë rekomandimet e tyre me qëllim të vendosjes së bazës të rekomandimit të politikave për rregullimin e një sistemi të qëndrueshëm të kontraktimit të shërbimeve në Kosovë.



Foto: Punëtorja me Këshillin për Bashkëpunim shoqëri civile- qeveri, për hartim të politikave për kontraktim të shërbimeve

Platforma CiviKos në bashkëpunim me Zyrën për Qeverisje të Mirë / Zyra e Kryeministrit ka organizuar punëtorinë dy-ditore me ekipin punues për zhvillimin e praktikave dhe procedurave për kontraktimin e OShC-ve për ofrimin e shërbimeve publike në Hotel Brezovica. Kjo punëtori është zhvilluar, në kuadër të Këshillit për Bashkëpunim Qeverisë - Shoqërinë Civile, si dhe me përfaqësues të organizatave që ofrojnë shërbime në Kosovë. Gjatë këtij aktiviteti u finalizua dokumenti 'Rekomandimi i Politikave për Kontraktim të Shërbimeve nga OSHC-të në Kosovë', dokument i cili do të shërbej si bazë për hartimin e legjislacionit sekondar për kontraktim të shërbimeve nga ana e OSHC-ve në Kosovë.



Foto: Punëtorja dy ditore për finalizimin e dokumentit Rekomandimi i Politikave për Kontraktim të shërbimeve në Kosovë

Diskutimi i Ekspertëve mbi praktikat e mira të kontraktimit të shërbimeve për OSHC-të (Praktikat Rajonale dhe të Bashkimi Evropian)

CiviKos në bashkëpunim me European Center for Non For Profit Law kanë organizuar diskutimin e ekspertëve rreth praktikave të kontraktimit të shërbimeve në rajon dhe europë. Gjatë këtij takimi u prezantuan te gjeturat e raportit “Hartëzimi dhe Sfidat e Organizatave të Shoqërisë Civile në Ofrimin e Shërbimeve Sociale dhe Familjare në Kosovë”. Përfaqësuesit nga European Center for Non-for-Profit Law Stchiting dhe Bulgarian Center for Not – for – Profit Law prezantuan disa nga modelet e kontraktimit të shërbimeve në Bullgari, si dhe praktikat e kontraktimit të shërbimeve nga disa shtete të Europës duke sjellur një perspektive të re, dhe argumente pro dhe kundër për disa nga modelet e kontraktimit të shërbimeve.



Foto: Diskutim i ekspertëve- Praktikrat rajonale dhe të BE-së për kontraktim të shërbimeve nga ana e OSHC-ve

Publikimi i raporteve rreth kontraktimit të shërbimeve në Kosovë

Publikimi i raportit “Hartëzimi dhe Sfidat e Organizatave të Shoqërisë Civile në Ofrimin e Shërbimeve Sociale dhe Familjare në Kosovë”

Pas grumbullimit të dhënave nga organizatat ofruese të shërbimeve në Kosovë, Platforma CiviKos ka organizuar një takim fokus grupi me organizatat ofruese të shërbimeve me qëllim të validimit të gjeturave dhe finalizimit të raportit “Hartëzimi dhe Sfidat e Organizatave të Shoqërisë Civile në Ofrimin e Shërbimeve Sociale dhe Familjare në Kosovë”. Ky raport ka ofruar një pasqyrë të detajuar të sfidave që organizatat ofruese të shërbimeve kanë në Kosovë, me fokus në ndikimin e pandemisë COVID-19 në punën e tyre. Raporti i plotë me të gjeturat e këtij hulumtimi është publikuar dhe dërguar te Këshilli për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile, si një dokument i cili do të ndihmojnë në zbatim të Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2013. Raportin e plotë e gjeni [këtu](#).

Publikimi i raportit “Korniza Ligjore në Republikën e Kosovës Lidhur me Kontraktimin e Shërbimeve nga OJQ-të”

Platforma CiviKos pas punëtorive me Këshillin për Bashkëpunim në mes të shoqërisë civile dhe qeverisë, dhe organizatave ofruese të shërbimeve ka publikuar edhe raportin e shkurtër përmbledhës “Korniza Ligjore në Republikën e Kosovës Lidhur me Kontraktimin e Shërbimeve nga OJQ-të”. Ky raport i shkurtër është një përmbledhje e legjislacionit të Kosovës që ofron hapësire dhe mundësi për kontraktim të shërbimeve për OJQ, nga ana e Qeverisë të Kosovës. Dokumentin e plotë e gjeni [këtu](#).



Foto: Raporti ‘Korniza Ligjore në Republikën e Kosovës Lidhur me Kontraktimin e Shërbimeve nga OJQ-të’

Finalizimi i dokumentit “Rekomandimi i Politikave Lidhur me Kontraktimin e Shërbimeve nga ana e OSHC-ve

Dokumenti “Rekomandimi i Politikave Lidhur me Kontraktimin e Shërbimeve nga ana e OSHC-ve”. Është dokumenti i përpiluar dhe publikuar nga CiviKos pas një procesi gjithëpërfshirës të akterëve të ndryshëm si Këshilli për bashkëpunim shoqëri civile qeveri, organizata ofruese të shërbimeve si dhe ekspert ë angazhuar vendos dhe ndërkombëtarë. Ky dokument do të shërbej si bazë për hartimin e legjislacionit sekondar për kontraktim të shërbimeve nga ana e OSHC-ve në Kosovë. Dokumentin e plotë e gjeni [këtu](#).




Foto: Raporti Rekomandimi i Politikave Lidhur me Kontraktimin e Shërbimeve nga ana e OSHC-ve

1.3 Aktivitetet në kuadër të Programit për Angazhim Qytetar (CEA)

Në shkurt të vitit 2022, Platforma Civikos ka filluar implementimin e aktiviteteve në kuadër të Programit për Angazhim Qytetar (CEA), projekt që zbatohet nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF), në partneritet me misionin e USAID në Kosovë. Programi për Angazhim Qytetar është program pesë-vjeçar i dizajnuar për të mbështetur OShC-të që të krijojnë konstituencat përmes një qasje me qytetarët në qendër, diversifikojnë bazën e resurseve dhe partnerëve, ndikojnë në ndryshim duke lidhur aktorët e ndryshëm përreth zgjidhjeve zhvillimore të drejtuara në nivel lokal, dhe për të përmirësuar llogaridhënien e qeverisë.

Platforma Civikos ka përgatitur disa infografika përmes të cilave shpaloset përmbajtja e Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023. Infografikat përmbledhin edhe rolin e anëtarëve të Këshillit për Bashkëpunim Shoqëri Civile - Qeveri, dhe veçanërisht rolin e anëtarëve të grupeve tematike që nëpërmjet bashkëpunimit me anëtarët e Këshillit e rrjedhimisht dhënies së ekspertizës tematike të ndikojnë në rritjen e zbatimit të Strategjisë.



Infografika: Përmbajtja e Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023

KËSHILLI PËR BASHKËPUNIM SHOQËRI CIVILE-QEVERI

Mekanizmi kryesor që do ta koordinojë të gjithë procesin e bashkëpunimit të qeverisë me shoqërinë civile do të jetë Këshilli për bashkëpunim qeveri-shoqëri civile.

Mandati i Këshillit nuk kufizohet vetëm në zbatimin e strategjisë qeveritare, por ai do të mbulojë të gjitha aspektet e bashkëpunimit në mes të qeverisë dhe shoqërisë civile duke përfshirë:

- Monitorimin e zbatimit të Strategjisë së Qeverisë për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023;
- Dhënien e opinionëve dhe këshillave për projektligjet, dokumentet strategjike dhe dokumentet tjera që ndikojnë në punën dhe zhvillimin e OSHC-ve, me qëllim të krijimit të një mjedisi më të përshatshëm për shoqërinë civile në Kosovë;
- Jep opinion për raportet vjetore mbi shpërndarjen e fondeve publike për mbështetjen e qëndrueshmërisë së programeve dhe projekteve të OSHC-ve.

Këshilli mbledhet dhe funksionon në bazë të rregullave të punës të miratuara bashkë me këtë strategji.

Anëtarët e Këshillit po ashtu janë të ndarë në katër grupe punuese sipas katër objektivave strategjike.

Derisa takimet e rregullta të këshillit janë formale puna kryesore e anëtarëve të këshillit është e fokusuar përmes grupeve punuese.

Secili anëtar i emëruar në grupet e punës do të marr pjesë në takimet e Këshillit dhe në aktivitetet e tjera për të siguruar përkushtimin e plotë të gjitha palëve të interesuara.

PLANI I VEPRIMIT TË STRATEGJISË QEVERITARE PËR BASHKËPUNIM ME SHOQËRINË CIVILE 2019-2023

Strategjia qeveritare ka një plan të veprimit të përgjithshëm si dhe një plan të punës për çdo vit kalendari. Strategjia do të ketë një vlerësim afatmesëm dhe një vlerësim final.

Nën koordinimin e Zyrës për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit dhe me përkrahjen e Ekiptëve të punës përgatiten Raportet e monitorimit të cilat dorëzohen në Këshill në baza vjetore.

Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit, e cili ka rolin kyç koordinues për zbatimin e Strategjisë/planit të veprimit dhe rrjedhimisht është përgjegjës për të siguruar ose koordinuar qasjen në të dhënat për grupet punuese për të qenë në gjendje t'i kryejnë detyrat e veta.

Kjo infografikë është mundësuar nga përkrahja e popullit Amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Përmbajtja e infografikës është përgjegjësi e Platformës Civikos dhe jo domosdoshmërisht reflekton pikëpamjet e USAID apo Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

Infografika: Këshilli për Bashkëpunim Shoqëri Civile - Qeveri

ROLI DHE DETYRAT E GRUPEVE AVOKUESE

Me qëllim që:

Të rritet gjithëpërfshirja e organizatave të shoqërisë civile në proces të zbatimit të Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me shoqërinë civile 2019-2023;

Të ketë më shumë pronësi nga ana e pjesëtarëve të shoqërisë civile në Kosovë, në proces të zbatimit të Strategjisë Qeveritare;

Të rritet zbatimi i Strategjisë Qeveritare;

Të avancohet bashkëpunimi në mes të shoqërisë civile dhe institucioneve publike.

Platforma CiviKos, me mbështetjen të Programit për Angazhim të Qytetarëve, një partneritet me USAID dhe Fondacionit Kosovari për Shoqëri Civile (KCSF), ka formuar katër grupe punuese/avokuese sipas katër objektivave strategjike të Strategjisë.

Grupet punuese do të kenë këto detyra/obligime:

Mbështetje tematike Këshillit për Bashkëpunim shoqëri civile-qeveri në zbatim të Strategjisë Qeveritare sipas katër objektivave strategjike

Mbështetje në zbatim të planit të punës së Strategjisë;

Avokim tek institucionet e Kosovës për zbatim të Strategjisë Qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile;

Avokim rreth avancimit të bashkëpunimit në mes të shoqërisë civile dhe institucioneve publike

Kjo infografikë është mundësuar nga përkrahja e popullit Amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Përmbajtja e infografikës është përgjegjësi e Platformës Civikos dhe jo domosdoshmërisht reflekton pikëpamjet e USAID apo Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

Infografika: Roli i grupeve tematike të themeluara nga Platforma CiviKos

Grupet tematike

Me qëllim që të rritet gjithëpërfshirja e shoqërisë civile në procesin e zbatimit të Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023, Platforma CiviKos, me mbështetje të Programit për Angazhim Qytetar, një partneritet mes USAID dhe Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF), ka themeluar katër grupe tematike me anëtarë nga shoqëria civile, bazuar në objektivat strategjike të Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023. Roli i këtyre grupeve është që t'i ofrojnë Këshillit për Bashkëpunim Shoqëri Civile – Qeveri ekspertizë tematike lidhur me zbatimin e objektivave të Strategjisë, respektivisht ta mbështesin Këshillin në identifikimin e sfidave dhe mangësive kryesore në këtë proces.

Në muajin prill, Platforma CiviKos ka organizuar takim informues në lidhje me rolin dhe detyrat e grupeve tematike në procesin e zbatimit të Strategjisë. Takimi është mbajtur virtualisht me pjesëmarrës nga të katër grupet.




Foto: Takimi i përbashkët informues me anëtarët e grupeve tematike

Grupet tematike kanë vazhduar punën dhe angazhimin nëpërmjet punëtorive, ku nga muaji qershor e deri në fund të vitit janë organizuar 16 punëtori të këtyre grupeve. Gjatë kësaj periudhe, anëtarët e grupeve kanë punuar në hartimin e rekomandimeve për rritjen e zbatimit të aktiviteteve në kuadër të objektivave përkatëse të Strategjisë, si dhe kanë analizuar aktivitetet dhe zhvillimet lidhur me Strategjinë, duke përfshirë dhënien e komenteve në koncept-dokumentet përkatëse.

Grupet tematike janë:

- Grupi tematik 1. Rritja e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në politikë-bërje;
- Grupi tematik 2. Përmirësimi i kornizës institucionale dhe ligjore për financim në zhvillimin e qëndrueshëm të programeve dhe projekteve të OShC-ve me interes publik;
- Grupi tematik 3. Zhvillimi i praktikave dhe procedurave për kontraktimin e OShC-ve për ofrimin e shërbimeve publike;
- Grupi tematik 4. Rritja e vullnetarizmit për programet me interes publik.



Foto: Grupi tematik 1



Foto: Grupi tematik 2



Foto: Grupi tematik 3



Foto: Grupi tematik 4

Takimet rajonale

Platforma CiviKos ka organizuar dy seri të takimeve me organizata lokale dhe aktivistë të shoqërisë civile në shtatë rajonet e Kosovës: Prishtinë, Pejë, Prizren, Gjakovë, Mitrovicë, Gjiilan dhe Ferizaj, ku është diskutuar për Strategjinë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023, nivelin e zbatimit të saj dhe rolin e shoqërisë civile në këtë proces.

Seria e parë e takimeve është organizuar gjatë muajit qershor, ku Platforma CiviKos ka shpalosur përmbajtjen e Strategjisë Qeveritare, duke elaboruar rolin e Këshillit për Bashkëpunim Shoqëri Civile - Qeveri në procesin e zbatimit të kësaj Strategjie e në veçanti grupet tematike të themeluara nga CiviKos.



Foto: Takimi me organizata të shoqërisë civile në Prishtinë



Foto: Takimi me organizata të shoqërisë civile në Gjiilan



Foto: Takimi me organizata të shoqërisë civile në Prizren

Seria e dytë e takimeve rajonale u organizuara gjatë periudhës tetor - nëntor. Në këto takime, Platforma CiviKos prezantoi të gjeturat nga monitorimi i zbatimit të Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile për periudhën 2019-2021. Përveç diskutimeve të zhvihuara në lidhje me zbatimin e Strategjisë Qeveritare, në këto takime diskutua edhe për sfidat me të cilat përballen organizatat e shoqërisë civile në aktivitetet e tyre të përditshme.



Foto: Takimi me organizata të shoqërisë civile në Prishtinë



Foto: Takimi me organizata të shoqërisë civile në Gjakovë



Foto: Takimi me organizata të shoqërisë civile në Pejë



Foto: Takimi me organizata të shoqërisë civile në Mitrovicë

Takimet me përfaqësuesit e shoqërisë civile në Këshillin për Bashkëpunim Shoqëri Civile - Qeveri

Platforma CiviKos ka organizuar takime me përfaqësuesit e shoqërisë civile në Këshillin për Bashkëpunim Shoqëri Civile - Qeveri. Këto takime kishin fokus kryesor koordinimin e anëtarëve të shoqërisë civile në Këshill në procesin e zbatimit të Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile, respektivisht bashkëpunimin në mes tyre dhe me anëtarët e grupeve tematike të themeluara nga CiviKos, drejt rritjes së zbatimit të objektivave të Strategjisë.



Foto: Takimi me anëtarët e shoqërisë civile në Këshill

Takimet me sekretarët e përgjithshëm të ministrive dhe Zyrës së Kryeministrit

Me qëllim që të sigurohet zbatim i efektshëm i Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile, Platforma Civikos bashkë me Zyrën për Qeverisje të Mirë ka mbajtur takime të vazhdueshme me Zv. Sekretarin e Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit si dhe me sekretarët e ministrive përgjegjëse për zbatim të Strategjisë (Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve; Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal; Ministria e Punëve të Brendshme; Ministria e Drejtësisë). Këto takime kishin si temë kryesore të diskutimeve rëndësinë e zbatimit të objektivave të Strategjisë dhe punën e ministrive përkatëse në këtë proces.



Foto: Takimi me Zv. Sekretarin e Përgjithshëm të ZKM-së



Foto: Takimi me Zv. Sekretaren e MAPL-së

Monitorimi i Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023

Platforma Civikos ka publikuar Raportin e Monitorimit të Zbatimit të Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023, për periudhën 2019-2021. Raporti pasqyron të gjeturat kryesore nga monitorimi i zbatimit të aktiviteteve të planifikuara bazuar në Planin e Veprimit të Strategjisë për periudhën 2019-2021. Më konkretisht, në raport janë të përmbledhura të arriturat dhe mangësitë kryesore në zbatimin e Strategjisë, dhe rekomadimet për përmirësim në këtë proces. Raportin e plotë e gjeni [këtu](#).



Foto: Raporti i Monitorimit të Zbatimit të Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023, për periudhën 2019-2021

2. RRITJA E BASHKËPUNIMIT SHOQËRI CIVILE - QYTETARË

2.1 Projekti “Përforcimi i Zërave Lokal Përmes Pjesëmarrjes Aktive”

Bashkëpunimi me institucionet qendrore

Fillimviti 2022 përfshinte një seri takimesh kooordinuese me partnerë të ndryshëm për të planifikuar aktivitetet dhe çështjet në të cilat Platforma CiviKos mund të kontribuoj në kuadër të projektit “Përforcimi i Zërave Lokal Përmes Pjesëmarrjes Aktive”. Ky projekt, i financuar nga National Endowment for Democracy (NED), filloi në shtator të vitit 2021 dhe gjatë kohëzgjatjes njëvjeçare (deri në shtator 2022), kishte për qëllim ngritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje lokale dhe rritjen e bashkëpunimit në mes organizatave me bazë në komunitet, qytetarëve aktiv dhe institucioneve publike lokale.

Në janar të vitit 2022, ekipi i Platformës CiviKos takoi znj. Krenare Sogojeva Dermaku, Komisionere e Agjencisë për Informim dhe Privatësi (AIP), dhe znj. Flutura Hoxha, Udhëheqëse e Divizionit për Hartim dhe Harmonizim të Legjislacionit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL). Takimet rezultuan të dobishme drejt qasjes dhe organizimit të aktiviteteve me Këshillat Lokale dhe sidomos dizajnit të platformës për lehtësimin e qasjes në dokumentet publike. Kjo e fundit është njëra nga dy fushat kryesore mbi të cilat shtrihet mandati i AIP-së, ndaj takimet në mes të AIP-së, CiviKos dhe organizatave të tjera të shoqërisë civile kanë qenë të vazhdueshme deri në lansimin e Platformës KerkoQasje.com (e shtjelluar mëposhtë).



Foto: Takimi me Komisionerën për Informim dhe Privatësi



Foto: Takimi me zyrtarët e MAPL-së

Përveç institucioneve qendrore të lartpërmendura, Platforma Civikos ka bashkëpunuar afër edhe me Institucionin e Avokatit të Popullit (IAP) për ngritjen e ndërgjegjësimit rreth mandatit të tyre. Për këtë qëllim, Platforma CiviKos organizoi diskutimin e përbashkët me IAP-në dhe përfaqësues të organizatave lokale dhe Këshillave Lokale, për të ndarë përvojat dhe rekomandimet për thellimin e bashkëpunimit në mes të IAP-së dhe shoqërisë civile. Pjesë e këtij diskutimit ishin Avokati i Popullit, z. Naim Qelaj, tre këshilltarët ligjor nga zyret regjionale të IAP-së, gjegjësisht z. Mark Kaqinari (IAP Gjakovë), znj. Aleksandra Dimitrijevic (IAP Graçanicë), z. Arbër Berisha (IAP Mitrovicë) dhe z. Ehat Miftaraj nga Kosovo Law Institute. Rëndësi e veçantë iu kushtua funksionimit të Forumit të Shoqërisë Civile dhe nevojës për rritjen e komunikimit të IAP-së me mediat dhe shoqërinë civile, në mënyrë që puna e këtij institucioni të jetë më e qasshme dhe e kuptueshme për të gjithë qytetarët.



Foto: Konferenca e Përbashkët me Institucionin e Avokatit të Popullit

Drejt qëllimit të ngritjes së ndërgjegjësimit dhe qasjes në informatave të dobishme mbi punën e Institucionit të Avokatit të Popullit, Platforma CiviKos ka përgatitur dhe shpërndarë infografikat për pikat e kontaktit të IAP-së në tërë Kosovën dhe çështjet që mandati i tyre mbulon.



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit
Institucija Ombudsmana
Ombudsperson Institution

INSTITUCIONI I AVOKATIT TË POPULLIT (IAP) NËPËR KOSOVË

Adresat ku qytetarët mund t'i drejtohen IAP-së në rast të pretendimit të shkeljes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut nga autoritetet publike në vend

IAP - Mitrovicë Veri
Rr. "Sami Frashëri", pn. Lagja e boshnjakëve,
Ndërtesa e ZAK në veri të Mitrovicës
Telefoni: +383 (0)45 455 319

IAP - Mitrovicë Jug
Rr. "Afrim Zhitia" p/n, Ndërtesa e APK
kati III, zyret nr. 11 dhe 12.
Telefoni: +383 (0) 28 530 138

IAP - Pejë
Rr. "Mbretëresha Teutë", Nr.59,
Ndërtesa e Komunës, Kati III, nr. 3
Telefoni: +383 (0)39 432 931

IAP - Gjakovë
Rr. "Ismail Qemali"
(ish ndërtesa e Kadastrës)
Telefoni: +383 (0)390 327 698

IAP - Prizren
Rr. "Remzi Ademi", pn, Ndërtesa
e AP Regjionale, kati i III
Telefoni: +383 (0)29 222 138

IAP - Prishtinë / Zyra Qendrore
Rr. "MIGJENI", nr. 21, 10000 Prishtinë
+383(0)38 223 782
Thirrjet falas për palët: 0800 15555

IAP - GRAÇANICË
Rr. "Car Lazari" p.n. Graçanicë
Telefoni: +383 (0) 44 322 979

IAP - Gjiilan
Rruga "Bulevardi i Pavarësisë"
(ish ndërtesa e gjykatës) p.n.
Telefoni: +383 (0)280 320 843

IAP - Ferizaj
Ndërtesa e Komunës (Kati përdhësë)
Telefoni: +383 (0)290 326 032



Infografika: Pikat e kontaktit IAP-së

Avokati i Popullit është institucion i themeluar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, e që i garanton parimin e mosndërhyrjes, të ndalimit të marrjes së udhëzimeve nga cilido autoritet në Kosovë, dhe detyrimin e çdo institucioni publik për t'u përgjigjur në kërkesat e tij.



Infografika: Mandati i IAP-së

Bashkëpunimi me qeverisjet lokale dhe organizatat lokale

Komponenti kryesor i këtij projekti ishte puna në terren me qytetarë aktiv, organizata lokale, Këshlla të Fshatrave dhe Lagjeve, si dhe qeveritë lokale. Gjegjësisht, projekti parashihte këtë punë në gjashtë qytete target: Dragash, Prizren, Ferizaj, Lipjan, Shtime dhe Viti. Para çfarëdo planifikimi aktivitetesh në këto komuna, Platforma CiviKos fillimisht kishte përzgjedhur organizatat anëtare nga këto komuna si partner të implementimit të aktiviteteve: Qendrën Rinore Avoko në Dragash, Ec Ma Ndryshe në Prizren, INPO në Ferizaj, YAHK në Lipjan, OJQ Akademia në Shtime dhe Politeia në Viti.

Pas koordinimeve të para me organizatat partnere, ekipi i CiviKos u takua edhe me zyrtarët komunal të secilës komunë target për t'i njoftuar ata me qëllimet dhe aktivitetet e projektit. Diskutimet kishin në fokus bashkëpunimin me shoqërinë civile lokale për ngritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimarrje lokale, por edhe përputhshmërinë e nivelit lokal me standardet minimale të konsultimit publik, siç parasheh niveli qendror. Pas këtyre takimeve, është vërejtur se disa nga komunat kanë filluar të publikojnë dokumentet dhe thirrjet e tyre për konsultim publik në platformën elektronike.



Foto: Takimi me YAHR në Lipjan



Foto: Takimi me përfaqësues të organizatës partnere në Viti



Foto: Takimi me përfaqësues të Komunës së Vitisë



Foto: Takimi me Përfaqësues të Komunës së Dragashit

Punëtoritë dyditore me përfaqësues të Këshillave Lokale dhe organizatave të shoqërisë civile

Gjatë periudhës mars-qershor, Platforma CiviKos në bashkëpunim me organizatat partnere nga komunat target të projektit ka organizuar punëtoritë dyditore me përfaqësues të Këshillave të Fshatrave dhe Lagjeve dhe orgnizatave lokale. Qëllimi i tyre ishte rritja e njohurive rreth mekanizmave të pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse në nivel lokal, dhe mënyrat e avokimit dhe ndikimit të politikave në nivel lokal. Këto punëtori i kanë shërbyer përgatitjes për dëgjimet buxhetore komunale që kanë filluar në qershor dhe janë finalizuar në shtator. Me perfundimin e serisë së punëtorive dhe monitorimit të degjimeve buxhetore, Platofrma CiviKos ka përgatitur materiale informuese, më specifikisht infografika dhe video, me qëllim ngritjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve për rëndësinë e proceseve vendimmarrëse lokale.



Foto: Punëtori në Lipjan



Foto: Punëtori në Shtime



Foto: Takimi me organizatat partnere të rajonit të Ferizajit

Infografika në vijim përmbledhë të dhënat nga punëtoritë në komunat e targetuara. Roli i organizatave anëtare të Platformës CiviKos ka siguruar zbatimin efektiv të aktiviteteve dhe arritjen e përgjithshme të objektivave të projektit.



Infografika: Të dhënat nga punëtoritë për ngritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse lokale

Lansimi i Platformës KerkoQasje.com

Platforma CiviKos, në bashkëpunim me Agjencinë për Informim dhe Privatësi, ka punuar intenzivisht në ndërtimin e një platforme e cila do të shërbente si mjet për të lehtësuar procesin e kërkesave për qasje në dokumente publike për shoqërinë civile dhe qytetarët. Në mënyrë që kjo platformë të jetë e lehtë e përdorshme, si dhe të bazohet në nevojat e OShC-ve, gazetarëve dhe qytetarëve, CiviKos organizoi takime të vazhdueshme dhe një fokus grup me disa përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile në Kosovë. Gjegjësisht, me përfaqësuesit e organizatave BIRN Kosovo, Organizata Çohu / Preportr, Kosova Democratic Institute / Transparency International Kosova, Kosovo Laë Institute, Lëvizja FOL dhe Open Data Kosovo, të cilët kontribuan me ide të ndryshme që kjo platformë të jetë lehtë e përdorshme, dhe të ndërgjegjësoj institucionet për përmirësimin e qasjes në dokumente publike. Çfarë në fillim u mendua të jetë një mjet lehtësimi për kërkesat e qasjes në dokumentet publike për organizatat dhe Këshillat Lokale të komunave target të projektit, u kthye në një platformë që shërben për çdo qytetar të interesuar t’iu drejtohet institucioneve publike dhe të pavaruara me kërkesa të tilla, siç garantojnë ligjet në fuqi.



Foto: Takimi me Agjencinë për Informim dhe Privatësi për platformën KerkoQasje

Ngjarja e organizuar me 21 shtator, kishte qëllim të dyfishtë – përmbylljen e projektit ‘Përforcimi i Zërave Lokal përmes Pjesëmarrjes Aktive’ mbështetur nga National Endowment for Democracy dhe lansimin e platformës për lehtësimin e kërkesave për qasje në dokumente publike ‘KerkoQasje.com’. Ngjarja filloi me një përmbledhje të shkurtër të aktiviteteve të projektit, materialeve të prodhuara në kuadër të tij, dhe rezultateve nga puna në terren. Më pas, paneli i përbërë nga znj. Krenare Sogojeva Dërmaku, Komisionere e Agjencisë për Informim dhe Privatësi, dhe z. Arton Demhasaj, Drejtor Ekzekutiv i ÇOHU, diskutuan sfidat e deritanishme për qasje në dokumente publike, rastet e ndëshkimit të institucioneve publike, dhe mundësitë e bashkëpunimit në mes të shoqërisë civile dhe IAP për përmirësimin e mëtutjeshëm të kësaj çështje. Pas prezantimit të funksionimit të platformës, gjatë diskutimit të hapur u theksua nevoja për rishikimin dhe qartësimin e Ligjit aktual për Qasje në Dokumente Publike dhe klasifikimi i dokumenteve në ato që janë të hapura dhe dokumente që duhet të dërgohet kërkesë e veçantë për qasje.



Foto: Lansimi i KerkoQasje.com

Si rezultat i implementimit të suksesshëm të këtij projekti, National Endowment for Democracy ka vazhduar mbështetjen e këtij projektit për një cikël të dytë shtator 2022 - shtator 2023, me target Komunën e Klinës, Gjakovës, Mitrovicës, Vushtrrisë, Fushë Kosovës dhe Kamenicës. Tremujori i parë i projektit është fokusuar në vendosjen e bashkëpunimeve të nevojshme për organizimin e aktiviteteve në komunat e lartpërmendura.

2.2 Auditimi Social në Kamenicë, Rahovec, Lipjan dhe Pejë

Platforma CiviKos me mbështetje të projektit për Decentralizim dhe Përkrahje të Komunave (DEMOS), projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) bashkëfinancuar nga Suedia dhe Norvegjia, dhe zbatuar nga HELVETAS Sëiss Intercooperation-Kosovo, ka mbështetur katër grupe të qytetarëve në katër komunat partnere Pejë, Lipjan, Kamenicë dhe Rahovec për të monitoruar 4 projekte kapitale të mbështetura nga granti i performancës.

Auditimi social si një mjet për të kërkuar llogaridhënie qytetare tek autoritetet komunat është bazuar në parimet themelore të qeverisjes demokratike dhe të mirë, që do të thotë se procesi ka qenë pjesëmarrës, gjithëpërfshirës, transparent, me qasje në informatat e nevojshme, dhe se vendimmarrësit dhe politike-bërësit mbahen përgjegjës.

Projektet e përzgjedhura në kuadër të Auditimit Social në katër komunat partnere

Katër projektet nga katër komunat partnere, Pejë, Kamenicë, Rahovec, dhe Lipjan që janë përzgjedhur për auditim social janë:

- Rregullimi i Parkut Karagaç në Komunën e Pejës;
- Projekti për shpërndarjen e ujit për fshatrat Hogosht dhe Lisockë në Komunën e Kamenicës;
- Ndërtimi i infrastrukturës për persona me nevoja të veçanta në Komunën e Rahovecit (Rahovec, Xërxë, Fortesë, Krushë e Madhe, Celinë, Hoqë e Vogël, Opterushë, Malësi e Vogël, Ratkoc, Dejn dhe Qifllak); dhe
- Ndërtimi i Rezervuarit të Ujit dhe Rehabilitimi i Rrjetit të Ujësjetës në Janjevë në Komunën e Lipjanit.

Mbështetja e Grupeve të Auditimit Social dhe lehtësimi i takimeve në katër komunat partnere

Pas themelimit të katër grupeve të qytetarëve në katër komunat partnere, CiviKos ka organizuar trajnimet fillestare për katër grupet e Auditimit Social.

Menjëherë pas trajnimeve, katër grupet e qytetarëve kanë filluar me monitorimin e katër kontratave të përzgjedhura. Gjatë monitorimit të projekteve, Grupet e Auditimit Social kanë bërë vizita në terren në katër komuna për të mbledhur informacione dhe për të vlerësuar progresin e projekteve. Grupi i qytetarëve të angazhuar në kuadër të auditimit social kanë patur një rol të rëndësishëm në procesin e monitorimit të projekteve, duke vlerësuar projektet nga këndvështrime të ndryshme.

Nëpërmjet trajnimeve, Grupet e Auditimit Social kanë përfituar njohuri dhe shkathtësi të reja për të ndjekur procesin e monitorimit dhe për të vlerësuar efektivitetin e projekteve të ndryshme. Grupet e Auditimit Social kanë mësuar si të identifikojnë dhe adresojnë çështje kritike, si dhe si të mrbajnë një komunikim të hapur dhe të përgjegjshëm me institucionet publike dhe komunitetin lokal.

Për secilin projekt, një Memorandum i Mirëkuptimit është nënshkruar midis CiviKos dhe kryetareve të katër komunave partnere për të siguruar bashkëpunimin dhe transparencën e nevojshme.

Grupet e Auditimit Social me lehtësim të CiviKos do të hartojnë katër raporte me gjetjet dhe rekomandimet kryesore për komunat partnere, të cilat raporte do të publikohen në fillim të vitit 2023.



Foto: Trajnimi me Grupin e Auditimit Social në Pejë



Foto: Takimi me Grupin e Auditimit Social në Janjevë



Foto: Punëtori me Grupin e Auditimit Social në Rahovec



Foto: Punëtori me Grupin e Auditimit Social Kamenicë

2.3 Vazhdimi i kampanjës për promovimin e vaksinimit #NiseMuhabetin

Konferenca: “2 vjet me Pandeminë – vazhdim i përpjekjeve për një menaxhim më të mirë”

Platform CiviKos në janar dhe shkurt të vitit 2022 ka vazhduar me kampanjën #NiseMuhabetin, kampanjë e cila kishte filluar në tetor të vitit 2021 dhe është mbështetur nga Slovak Aid. Qëllimi i aktiviteteve të këtij projekti promovim i vaksinimit kundër COVID-19 dhe ndërgjegjësimi i drejt për mbrojtjen nga COVID-19. Në kuadër të kësaj kampanje janë publikuar materiale të ndryshme informuese, si video dhe fletushka.

Projekti u përmbyll me konferencën ‘2 vjet me Pandeminë – vazhdim i përpjekjeve për një menaxhim më të mirë’, e cila mbledhi hisedarë të sektorëve të ndryshme, si gazetarë, përfaqësues të shoqërisë civile dhe sektorit të biznesit për të diskutuar përvojat e tyre në përballje me pandeminë dhe rekomandimet e tyre për të vazhduar tutje me një koordinim më të mirë.



Foto: Konferenca përmbyllëse e Projektit #NiseMuhabetin

Promovimi i vaksinimit kundër virusit Covid-19:



Janë shpërndarë **broshura** informuese, me mite dhe fakte për vaksinimin kundër Covid-19.



Janë shpërndarë **video** informuese rreth vaksinimit kundër Covid-19.



Promovimi i vaksinimit kundër Covid-19 ka qenë shumë aktiv përmes **mediave sociale**.



Panel diskutimi për vazhdimin e përpjekjeve për menaxhim më të mirë të pandemisë.



Zbatimi i projektit #NiseMuhabetin mbështetet nga skema e granteve të vogla të SlovakAid.

Janë mbajtur ligjerata nga mjeku për rëndësin e vaksinimit kundër virusit Covid-19, në pesë qytete të Kosovës.

KLINË



MITROVICË



GJAKOVË



DRAGASH



GJILAN



Infografika: Aktivitetet në kuadër të projektit #NiseMuhabetin

Aktivitetet e Platforma Civikos gjatë periudhës dy vjeçare të pandemisë kundër Covid-19.



Inicativë vullnetare së bashku me organizatat Artpolis - Art and Community, Democracy Plus, PEN - Peer Educators Network, KCSF - Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile dhe YMCA.

Maska të shpërndara në Prishtinë, Vushtri, Mitrovicë e Jugut, Pejë, Prizren, Fushë Kosovë etj.

Avokim përmes mediave sociale në respektim të masave kundër Covid-19.



Platforma Civikos në bashkëpunim me Odën Ekonomike të Kosovës dhe me mbështetje të UN Kosovo TEAM lanconi platformën Realitet i Ri.



Platforma Realitet i Ri erdhi si përgjigje ndaj nevojës së shpërndarjes dhe thjeshtimit të informatave të besueshme e të përditësuar në lidhje me masat kundër Covid-19, me fokus shëndetin dhe sigurinë në ambientet e punës të sektorit privat.

Trajnime për Gastronominë për Sigurinë dhe Shëndetin në Vendlin e Punës me trajner të certifikuar.

1 Kampanja #VendoseMaskën

2 Ri-formësimi i Shoqërisë Civile në Kosovë si pasojë pandemisë COVID-19

3 Platforma Realitet i Ri

4 Kampanja #NiseMuhabetin



Mbështetur nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS).

Janë mbajtur 4 panele diskutimi (online).

Promovimi i organizatave anëtare për punën gjatë periudhës së karantinës në pandemi.

Është publikuar raporti me infografika "Dy Qeveri - Një Pandemi".

Infografika informuese rreth masave të Qeverisë së Republikës së Kosovës kundër COVID-19.



Mbështetur nga skema e granteve të vogla të SlovakAid.

Ligjerata me mjekun për promovim të vaksinimit kundër Covid-19, janë mbajtur në: Dragash, Gjakovë, Gjilan, Klinë dhe Mitrovicë.

Infografika informuese me fakte dhe mite rreth vaksinimit kundër Covid-19.

Video informuese rreth vaksinimit kundër Covid-19.



Infografika: Aktivitetet e Platformës CiviKos gjatë periudhës dy vjeçare kundër të pandemisë COVID-19.

3. SHËRBIMET E SEKRETARIATIT TË PLATFORMA CIVIKOS PËR ORGANIZATAT ANËTARE

3.1 Të gjeturat e raportit të BE-së për Kosovën 2022

Sekretariati i CiviKos ka përmbledhur në një infografikë të veçantë të gjeturat e raportit të Bashkimit Evropian (BE) për Kosovën, respektivisht mesazhet kryesore për shoqërinë civile.



Infografika “ Mesazhet kryesore të raportit të progresit për SHC, 2022”

3.2 Avokimi për politikat kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në Kosovë



Foto: Punëtorja “Politikat kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në Kosovë”- Ndikimi në punën e OSHC-ve në Kosovë

Platforma CiviKos me mbështetje të organizatës Human Security Collective ka vazhduar me aktivitetet avokuese në fushën e politikave kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si dhe ndikimit në punën e shoqërisë civile në Kosovë.

Me 3 nëntor 2023 CiviKos organizoi punëtorinë “Politikat kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në Kosovë”- Ndikimi në punën e OSHC-ve në Kosovë.

Kjo punëtori është udhëhequr nga z. Dren Puka nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF), njëherit edhe anëtarë i grupit punues për plotësim ndryshimin e legjislacionit kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në Kosovë.

Pjesëmarrësit kishin mundësi të informoheshin rreth politikave kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në Kosovë, dhe ndikimin që këto politika kanë në punën e shoqërisë civile. Po ashtu gjatë punëtorisë u diskutua rreth vlerësimit të rrezikut sektorial, dhe rëndësisë së pjesëmarrjes së organizatave të shoqërisë civile në këtë proces të vlerësimit që Kosova është duke e kaluar.

3.3 Shërbimi informues për organizatat anëtare gjatë vitit 2022

Sekretariati i CiviKos gjatë vitit 2022 ka dërguar buletin e rregullt javor për organizatat anëtare. Buletini javor me informata si; mundësi për grante, mundësi për pjesëmarrje në trajnime, seminare të ndryshme, mundësi rrjetëzimi, si dhe informata relevante për shoqërinë civile është dërguar tek organizatat anëtare në baza javore përgjatë gjithë vitit. Anëtarët e Platforma CiviKos kanë pranuar 50 buletine, gjatë vitit 2022.

3.4 Përzgjedhja e anëtareve të shoqërisë civile në trupa të ndryshëm publik

Sekretariati i Platforma CiviKos edhe gjatë vitit 2022 me kërkesë të institucioneve të ndryshme publike ka lehtësuar përzgjedhjen e anëtareve të shoqërisë civile në trupa të ndryshëm publik. Gjatë vitit 2022 CiviKos ka lehtësuar përzgjedhjen e anëtareve të shoqërisë civile për këto institucione publike:

- Thirrje për nominime për përfaqësues të shoqërisë civile në Këshillin për Demokraci dhe të Drejta të Njeriut, nga Zyra e Presidentes të Republikës së Kosovës;
- Thirrje për dy përfaqësues të shoqërisë civile si pjesëmarrës të procesit të vlerësimit të granteve dhe subvencioneve për vitin 2023- Komuna e Prishtinës;
- Thirrje e hapur për 10 (dhjetë) përfaqësues të shoqërisë civile si monitorues të procesit të vlerësimit të granteve për zhvillim rural 2022- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
- Thirrje për përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile që veprojnë në Kosovë për Këshillin për Bashkëpunim shoqëri civile qeveri 2019-2023.

